

## Hasan Lika: Jemi brenda objektivave per sezonin

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 14 Nentor 2013 21:19

---



I kenaqur nga fitorja trainer i Partizanit ka folur per objektivat. Hasan Lika ndihet mire per ecurine e te kuqve dhe per faktin se me tre golat e Malos ndaj Teutes u kalua kriza e rezultateve. “Kemi bere mire ne fazen e pare te kampionatit. E nisem me ritmin e duhur por me pas patem disa probleme. Skuadra ka punuar me seriozitet dhe une them se jemi brenda objektivave. Ndodhemi ne vendin e katert dhe shume prane zones qe na dergon ne Europe. Per kete do te punojme. Na duhet perqendrim maksimal pasi ne vazhdim ndeshjet do te jene gjithmone e me te veshtira. Merkato e janarit? Do te bejme disa nderhyrje por baza e skuadres nuk do te preket. Ne merkaton e dimrit mund te permiresosh pak gjera pasi ka pak mundesi ne treg”, ka deklaruar trajneri i Partizanit Hasan Lika.